RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
TELEVIZIONI
Nr. 1280/25
Data 05.06.2025
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2024, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të bashkangjitura ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për pozitën financiare të Radiotelevizionit të Kosovës deri me 31 dhjetor 2024, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme për vitin 2024, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë të përshkruara më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodit të Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Radiotelevizionit të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 RTK gjatë vitit 2024 kishte lidhur dy kontrata duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim, për të cilat nuk ishte evidentuar ndonjë situatë emergjente, as ndonjë rrethanë që e bënte të pamundur zbatimin e procedurave të tjera të hapura apo të kufizuara, siç kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik.

A2 Në një rast, përgatitja e specifikimeve teknike të dosjes së tenderit nuk ishte në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

B1 RTK ka vazhduar kontratën për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese me kompensim në kundërshtim me zbritjet e lejuara me rregulloren për marketing.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), dhe ligjet tjera të zbatueshme nga ana e RTK-së.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Radiotelevizionit të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Radiotelevizionit të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Radiotelevizionit të Kosovës në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme për RTK-në.[2]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet qe të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Radiotelevizioni i Kosovës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Radiotelevizionit të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Radiotelevizionit të Kosovës, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që RTK të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Te konkluzioni i pajtueshmërisë çështja që ka ndikuar ishte kontrata për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese me kompensim, përdorimi i procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë si dhe kriteret diskriminuese në dosje të tenderit, ndërsa çështjet tjera të cilat nuk kanë ndikuar te opinion por vetëm të menaxhimit financiar dhe pajtueshmërisë janë: pronësia e pa definuar e pasurive /objekteve ku operon RTK, prokurimet e shpeshta me vlera minimale,

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, një (1) i përsëritur dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Përdorimi i procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë

Gjetja

Sipas nenit 35 të LPP-së, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për dhënien e çdo lloj kontrate, nëse rrethanat e arsyetojnë përdorimin e kësaj procedure. Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim publik, neni 52.3 autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që ekzistojnë rrethana precize që i arsyetojnë negociatat para se të vendoset për përdorimin e kësaj procedure. Rasti ku kjo procedurë mund të përdoret: -Kur për arsye teknike ose artistike ekziston vetëm një operator i mundshëm ekonomik, -Në rastet e urgjencës ekstreme.

Gjatë vitit, 2024 RTK kishte lidhur kontratë duke përdorur procedurën e negociuar pa publikim për lidhjen e një kontrate për "Realizimin e dizajnit dhe grafikeve për Festivalin e Këngës në RTK 2024" në vlerë prej 10,150€ me një kompani nga Shqipëria, pa dokumentuar qartë arsyetimin ligjor për shmangien e publikimit dhe konkurrencës. Nuk ishte evidentuar ndonjë situatë emergjente, as ndonjë rrethanë që e bënte të pamundur zbatimin e procedurave të tjera të hapura apo të kufizuara, siç kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik.

Gjithashtu, RTK nuk kishte arritur të bënte zgjidhje afatgjatë ose me kohë për shfrytëzimin e veturave për nevojat e RTK-së edhe pse kishte kontratë publike për 60 muaj. Pas skadimit të kësaj kontrate kishte përdorur procedurë të negociuar për kontratën "Shfrytëzimi afatshkurtër i veturave për nevojat e RTK-së" në vlerë 33,900€.

Sipas vendimit të aprovuar nga zëvendës drejtori të përgjithshëm i RTK-së për fillimin e kësaj procedure, ishte arsyetimi se mungesa e stafit të profilizuar për dizajnimin grafik ka shfaqur nevojën që për festivalin e këngës të angazhohen shërbime nga jashtë RTK-së. Në anën tjetër, shfrytëzimi afatshkurtër i veturave ishte për shkak të menaxhimit jo të duhur dhe mungesës së planifikimit për këto shërbime.

Ndikimi

Përdorimi i procedurës së negociuar rrit rrezikun për mungesë të konkurrencës, përzgjedhje jo optimale të operatorëve ekonomik dhe keqpërdorim të fondeve publike. Gjithashtu, cenohet transparenca dhe besimi i publikut në menaxhimin e kontratave publike.

Rekomandimi A1

Bordi i RTK-së duhet të shmangë përdorimin e procedurave të negociuar pa publikim, përveç rasteve kur kjo justifikohet plotësisht sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin përkatës. Përdorimi i procedurave të hapura dhe transparente duhet të jetë parimi themelor në realizimin e prokurimeve, me qëllim sigurimin e konkurrencës së drejtë, efikasitetit në shpenzimin e fondeve publike dhe rritjen e besimit të publikut në procesin e prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kritere diskriminuese në dosje të tenderit

Gjetja

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 28-specifikimet teknike, pika 7 thekson që AK nuk do të përpiloj specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose një burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose prodhimi. Po ashtu, sipas ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, neni 29, lirimet në importim, pika 1, nga TVSH-ja duhet të lirohen si në vijim, pika 1.14. pajisjet dhe materialet e importuara për nevojat e mediave të shkruara dhe elektronike. Në anën tjetër, sipas interpretimit të ATK-së për RTK-në me numër të protokollit 3248/13 konfirmon se RTK apo ndonjë kompani që importon mallra për RTK-në, të cilat shfrytëzohen me qëllim të realizimit të veprimtarisë mediale nga RTK, me rastin e importit nuk duhet të ngarkohen me TVSH.

Në dosjen e tenderit për "Shërbime teknike për festivalin e dytë të Këngës në Kosovë" në vlerë 96,840€, në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 5 është kërkuar që OE duhet të ketë listën e kontratave dhe referencat e lëshuara nga punëdhënësi që ku ka përfunduar me sukses ofrimin e shërbimeve teknike në ndriçimin dhe zërim në festivale apo në koncerte të mbyllura. Për më tepër, është përcaktuar që të paktën njëra nga këto kontrata të jetë për realizimin e festivalit të këngës të mbajtur në ndonjë televizion publik në rajon apo më gjerë për garën Kënga e Eurovizionit apo eventeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit për kontratë.

Ky kriter si i tillë ishte diskriminues, pasi në Kosovë nuk kishte pasur festivale të tilla të organizuara më parë dhe, si rrjedhojë, operatorët vendorë nuk kishin mundësi reale për të përmbushur këtë kërkesë, duke u përjashtuar në këtë mënyrë nga konkurrenca.

Në anën tjetër, OE kishte ofertuar me çmimin e përfshirë me TVSH në vlerë 16,140€ përkundër faktit që furnizimet dhe shërbimet nga importi të kësaj natyre ishin të liruara nga TVSH-ja sipas ligjit në fuqi.

Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e zyrës së prokurimit, duke mos i respektuar kërkesat ligjore gjatë përgatitjes së specifikave teknike. Për më tepër, në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk është specifikuar se operatorët ekonomikë që do të importojnë këto furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, duhet të kalkulojnë çmimin pa përfshirë TVSH-në, ashtu siç parashihet me legjislacionin tatimor në fuqi.

Ndikimi

Kjo praktikë e përcaktimit të kritereve diskriminuese mund të ndikojë në eliminimin e operatorëve ekonomik potencialisht më konkurrues duke e cenuar transparencën e procesit të prokurimit si dhe rrezikuar që RTK të mos përzgjedh ofertën më të favorshme ekonomikisht. Për më tepër, përfshirja e TVSH-së në ofertën e OE-së për furnizime që janë të përjashtuara nga TVSH ndikon në pagesa të paarsyeshme nga ana e RTK-së.

Rekomandimi A2

Bordi i RTK-së duhet të sigurojë që gjatë hartimit të dosjeve të tenderit të shmangë vendosjen e kritereve diskriminuese, në mënyrë që të garantohet konkurrencë e drejtë. Gjithashtu, në rastet kur furnizimet apo shërbimet janë të liruara nga tatimet, kjo duhet të qartësohet në dosje të tenderit, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Dobësi në kontratën për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese me kompensim

Gjetja

Sipas rregullës së RTK për marketing, neni 20 zbritjet nga çmimorja e marketingut, pika 2 kërkohet që: shkalla e zbritjeve në çmimoren e RTK-së kalkulohet në këtë mënyrë: vlera e zbritjes së parë shërben si bazë për zbritjen e dytë e kështu më radhë. Ndërsa neni 28 reklamimi me kompensim, përcakton që RTK u lejon 30% zbritje nga çmimorja bazë e marketingut të RTK-së, bizneseve, produksioneve, bashkëpunimeve afariste, programore, apo të tjera të cilat lidhin kontratë me kompensim me hapësirë reklamuese kur bëhet fjalë për përmbushjen e një misioni të caktuar të RTK-së.

Në mars të vitit 2023, RTK kishte lidhur kontratë në vlerë 44,449€ me kohëzgjatje 12 muaj për ofrimin e shërbimeve telefonike dhe mobile GSM me marrëveshje për kompensim. Megjithatë, në muajin maj të po të njëjtit vit ishte nënshkruar aneks për ndryshimin e pagesës së këtyre shërbimeve nga mjetet financiare në kompensim me hapësirë reklamuese duke i ofruar operatorit ekonomik zbritje direkte 50% nga çmimorja bazë (gjetja A5 në Raportin e auditimit për vitin 2023). Vlen të theksohet se RTK në aneks kontratën për kompensime me hapësira reklamuese ka bërë zbritje 50% nga çmimorja bazë e marketingut të RTK-së dhe jo sipas rregullores ku fillimisht do të duhet të bëhej zbritja e parë 30% e cila pastaj përdorët si bazë për zbritjen e dytë 20%.

Përkundër rekomandimit të dhënë në raportin e auditimit të vitit të kaluar për të mos vazhduar praktika të tilla pa rishikim të procedurave dhe respektim të rregulloreve përkatëse, në shkurt të vitit 2024, RTK ka vazhduar me vendim kontratën me të njëjtat kushte për një vit shtesë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrollit të duhur të brendshëm dhe mos zbatimit të rekomandimeve të auditimit duke mundësuar vazhdimin e kontratës me të njëjtat parregullsi.

Ndikimi

Vazhdimi i marrëveshjeve kontraktuale në kundërshtim me zbritjet e lejuara me kërkesat e rregullores për marketing, rrezikon që vlera e shërbimeve të ofruara të jetë më e ultë apo në kundërshtim me vlerat e hapësirave reklamuese me kompensim.

Rekomandimi B1

Bordi i RTK-së të sigurojë vendosjen e kontrolleve të brendshme që me rastin e ftesave për ofertë me kompensim të mbikëqyret procesi i ofertimit, të vendosen kushtet dhe kriteret që përmbushin shërbimet me kompensim për të siguruar që nënshkrimi i kontratës bëhet sipas ftesës dhe kritereve për zbritje të përcaktuara me rregullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë afatgjata

Vlera neto e zërit financiar të pasurive afatgjata e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 4,111,000€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me pajisjet dhe makineritë, inventari, pajisjet, seriale, drama, filma dhe programe tjera.

Çështja C1 - Pronësia e pa definuar e pasurive /objekteve ku operon RTK

Gjetja

Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik dhe Kornizës Konceptuale, Par. 5 BC 5.10 pronësia ligjore e një pasurie si një qasje në shërbime potenciale ose në përfitime ekonomike të një pasurie është një tregues i kontrollit. Megjithatë, të drejtat për shërbime potenciale ose aftësia për të krijuar përfitime ekonomike mund të ekzistojë pa pronësinë ligjore të pasurisë nëpërmjet mbajtjes dhe përdorimit të pronës.

Në shënimet kontabël dhe raportin e regjistrimit të mjeteve themelore në fund të vitit 2024, në regjistrin e pasurive dhe në raportin e rivlerësimit të pasurisë nuk është prezantuar ndërtesa në të cilën operon RTK. Pra, ligjërisht nuk është pronë e RTK-së, ajo i sjellë përfitime organizatës. Ndërtesa si e tillë, prej shumë vitesh shfrytëzohet nga ana e RTK-së pa asnjë dëshmi për të drejtën e shfrytëzimit. Objekti është dhënë në shfrytëzim nga AKP, mirëpo nuk është ofruar ndonjë dëshmi që dokumenton se prona dhe ndërtesa në fjalë është në menaxhim të AKP-së dhe për çfarë periudhe kohore është dhënë kjo e drejtë e shfrytëzimit.

Për adresimin e kësaj çështje menaxhmenti i RTK-së kishte zhvilluar takime me drejtuesi e AKP-së dhe është hartuar një propozim për zgjedhjen e çështjes së pronës së RTK-së, e cila është dërguar në Komisionin e Administratës Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për shqyrtim në maj 2023. Deri në kohën sa ishim në proces të auditimit RTK nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje nga Komisioni. Vlen të theksohet, RTK të gjitha informatat lidhur me statusin pronësor të objektit, i ka shpalosur edhe në PFV-të e vitit 2024.

Edhe përkundër iniciativave të bordit dhe menaxhmentit të RTK-së për të adresuar këtë çështje, si dhe rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Qeverinë që në bashkëpunim me AKP-në të definoj pronësinë e objektit të ish Radiotelevizionit të Prishtinës dhe statusin e kësaj prone, kjo çështje ende ka mbetur e pazgjidhur.

Ndikimi

Mungesa e pronësisë me status ligjor të konfirmuar për objektin ku operon dhe nga shfrytëzimi i saj ka nxjerrë përfitime ekonomike, krijon paqartësi pronësore dhe rrit rrezikun që RTK-së t'i pamundësohet ushtrimi i drejtave pronësore mbi pronën që potencialisht janë të RTK-së.

Rekomandimi C1

Bordi i RTK-së duhet të merr masa të menjëhershme dhe çështjen e këtij objekti ta diskutojë me Kuvendin e Kosovës dhe AKP-në në mënyrë që të sqarohet pronësia e përhershme apo dhënia në shfrytëzim për kohë të caktuar, dhe më pas, çështja të trajtohet edhe në aspektin kontabël të regjistrimit të saj.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative ishin 10,793,753€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzimet e të drejtave programore, produksionet vendore dhe të jashtme, shtesa për emisione, pastaj komunalitë, tarifat e licencës, shpenzimet e zyrës dhe ato administrative, shpenzimet e qirasë së veturave dhe të tjera.

Çështja A3 - Prokurime të shpeshta me vlera minimale

Gjetja

Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), neni 5, pika 5.3, thekson se përgatitja e planit vjetor të prokurimit: eliminon nevojën për prokurime emergjente apo përjashtime, mbledhë kërkesat kur është e mundshme për të fituar vlerën për paranë, mundëson identifikimin e kontratave kornizë dhe eviton ndarjen e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të njëjta ose të ndërlidhura.

Gjatë auditimit, në raportin e kontratave të nënshkruara për prokurimin e vitit 2024, ne vërejtëm se për furnizime të njëjta janë përdorur procedura me vlerë minimale në shtatë (7) raste të ndara. Nga këto, kemi testuar katër (4) raste apo procedura me vlera individuale prej 895€, 960€, 710€ dhe 650€, që lidhen me blerjen e printerëve, karrigeve dhe klimave për nevojat e RTK-së. Këto blerje ishin realizuar përmes procedurave me vlerë minimale duke shmangur kështu procedurat e hapura të prokurimit.

Ndarja e kërkesave ka rrjedhur si rezultat i mos identifikimit të nevojave për furnizime me kohë dhe planifikimit të dobët dhe jo të duhur të sasisë për këto furnizime.

Ndikimi

Përdorimi i përsëritur i procedurës me vlerë minimale dhe shmangia e procedurave të hapura të prokurimit cenon transparencën dhe kufizon konkurrencën në procesin e prokurimit. Gjithashtu, kjo mund të ndikojë që furnizimet e pranuara të mos jenë të cilësisë së duhur në raport me paranë e shpenzuar.

Rekomandimi A3

Bordi i RTK-së duhet të sigurojë që nevojat për furnizime të identifikohen me kohë dhe të përfshihen në planin vjetor të prokurimit, në mënyrë që të aplikohet procedura e duhur e prokurimit, duke garantuar transparencë, konkurrencë dhe sigurimin e vlerës për paranë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Radio Televizionit të Kosovës ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime kryesore. RTK kishte përgatitur/nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, pesë (5) rekomandime janë zbatuar; një (1) nuk ishte zbatuar dhe një (1) ishte pjesërisht i zbatuar, siç është paraqitur në Grafikun 1, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve). Vlen të theksohet se krahasuar me vitin e kaluar, ndërmarrja kishte bërë progres në adresimin e rekomandimeve, duke reflektuar në korrigjimet e duhura në pasqyra financiare.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i RTK-së të sigurojë që në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, të bëhet rivlerësimi i pasurive të RTK-së, me qëllim të prezantimit të vlerës së drejtë të tyre në Pasqyrat Financiare Vjetore.	RTK kishte kishte ndërmarrë hapat e nevojshëm për rivlerësimin e pasurisë sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Bordi i RTK-së të sigurojë vendosjen e kontrolleve të brendshme që me rastin e ftesave për ofertë me kompensim të mbikëqyret procesi i ofertimit, të vendosen kushtet dhe kriteret që përmbushin shërbimet me kompensim për të siguruar që nënshkrimi i kontratës bëhet sipas ftesës dhe kritereve për zbritje të përcaktuara me rregullore.	Nuk janë vendosur kontrollet e brendshme për t'u siguruar që në ftesat për kompensim janë vendosur kushtet dhe kriteret sipas rregullores.	Nuk ka filluar zbatimi

3.	Baza për konkluzion	Bordi i RTK-së të siguroj vendosjen e kontrolleve të brendshme përgjatë procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit duke respektuar kriteret e përcaktuara dhe nënshkrimi i kontratës të bëhet me kohë.	Nuk kemi hasur në vonesa të nënshkrimit të kontratave dhe konsiderohet që në këtë aspekt janë shtuar kontrollet e brendshme.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Bordi i RTK-së duhet të siguroj vendosjen e kontrolleve të brendshme përgjatë procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit në përshtatje me LPP, udhëzuesit dhe rregullave për procedurat e prokurimit në mënyrë që të respektohen afatet kohore të përcaktuara ligjor për pranimin e ofertave.	Në dosjet e testuara janë respektuar afatet kohore për pranimin e ofertave.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit zbatohen kriteret e vendosura në dosje të tenderit, duke kërkuar edhe sqarime shtesë aq sa e lejon ligji, për të siguruar se përzgjedhja e OE fitues bëhet vetëm pasi janë plotësuar kriteret e përcaktuara.	Nuk kemi hasur në raste kur nuk janë zbatuar kriteret e vendosura në dosjen e tenderit	I zbatuar
6.	Pasuritë afatgjata	Bordi i RTK-së duhet të merr masa të menjëhershme dhe çështjen e këtij objekti ta diskutojë me Kuvendin e Kosovës dhe AKP-në në mënyrë që të sqarohet pronësia e përhershme apo dhënia në shfrytëzim për kohë të caktuar, dhe më pas, çështja të trajtohet edhe në aspektin kontabël të regjistrimit të saj.	Menaxhmenti i RTK-ës është drejtuar Kuvendit të Kosovës me një raport për shqyrtimin e çështjes së definimit të pronësisë së objektit, por nuk është marr asnjë veprim ende nga Kuvendi i Kosovës.	Pjesërisht i zbatuar
7.	Shpenzimet e pagave	Bordi i RTK-së të sigurojë që të merren masa e nevojshme që të respektohen të gjitha udhëzimet për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të konkursit publik, si dhe të ushtrojë kontrolle në burimet njerëzore dhe tek komisionet e përzgjedhjes në mënyre që të plotësohen kushtet dhe kriteret e konkurseve gjatë vlerësimit.	RTK gjatë vitit 2024 nuk kishte zhvilluar numër të lartë të procedurave, në dy mostrat e testuara nuk kanë rezultuar me parregullsi.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Albana Kadriu, Anëtare e ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi





RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Dardan Beqiri,

Nënkryetar i Bordit në RTK

Data: 23 maj 2025, Prishtinë,



Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.

[2] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
TELEVIZIONI
Nr. 0427/25
Data 26.02.2025
PRISHTINË

RTK

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Radio Televizioni i Kosovës

Pasqyrat Financiare 31 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	08 – 34

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
Pasqyra e Pozicionit Financiar 31 dhjetor 2024

	Shënimi	2024 (në '000 Euro)	2023 (në '000 Euro)
ASSETS			
Asetet jo qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	4	2,723	2,129
Asetet e paprekshme	5	1,388	1,481
		4,111	**3,610**
Asetet qarkulluese			
Stoqet		8	18
Investimet ne pjesëmarrje	6	1	1
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	292	231
Paraja në dorë dhe në banka	8	5	332
		306	**582**
GJITHSEJT ASETET		**4,417**	**4,192**
EKUITETI DHE DETYRIMET			
Ekuiteti			
Kapitali themelues dhe rezervat	9	1,018	1,018
Fitimet e bartura	9	1,125	1,058
Rezervat e rivlersimit	9a	591	
		2,734	**2,076**
Detyrimet jo-rrjedhëse			
Te hyrat e shtyra nga grantet	10	627	736
		627	**736**
Detyrimet rrjedhëse			
Llogarit e pagueshme dhe të tjera	11	584	857
Total llogaritë e pagueshme dhe tregtare		**584**	**857**
Detyrimet tjera afatshkurtra		**416**	**374**
Huatë – afatshkurta			0
Tatime te pagueshme	12	1	0
Avanset nga klientet e marketingut		55	149
		56	**149**
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET		**4,417**	**4,192**

Autorizuar për publikim nga ana e menaxhmentit dhe e nënshkruar në emër të tyre më 24 Shkurt. 2025

Ztr. Hysen Hundozi	*Ztr. Gazmend Rexhepi*	*Ztr. Halil Bajramaj*
UD.Drejtor i Përgjithshëm	Zyrtar-kryesor Financiar	Menaxher i Kontabilitetit

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 8 deri 34 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
Pasqyra e fitmit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse 31 dhjetor 2024

	Shënimi	2024 (në '000 Euro)	2023 (në '000 Euro)
TË HYRAT OPERATIVE			
Te hyrat nga Buxheti i Kosovës	13	8,960	8,960
Të hyrat nga marketingu	14	714	524
Të hyrat tjera	15	1,187	1,186
		10,861	**10,670**
SHPENZIMET OPERATIVE			
Zhvlerësimi	4	-809	-567
Amortizimi	5		
Shpenzimet e stafit dhe bordit	16	-7,728	-8,151
Shpenzimet e programit dhe te tjera	17	-2,185	-1,413
Provizioni për borxhe të vjetra	7	-30	-42
Zërat që nuk I takojnë fitimit ose humbjes se vitit	18	-42	-374
		-10,794	**-10,547**
FITIMI / (HUMBJA) E VITIT		**67**	**123**
Te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Lirimi nga rivlerësimi i pasurisë			
Shlyerja e rezervave rivleresuese			
Te hyra tjera gjithëpërfshirëse			
TOTAL TË HYRA GJITHËPËRFSHIRËSE		**67**	**123**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 8 deri 34 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet 31 dhjetor 2024

	Kapitali dhe rezervat	Rezervat nga Rivlersimi	Fitimet e mbajtura	TOTALI
		----------(në '000 Euro)----------		
Gjendja me 1 Janar, 2024				
Kapitali themelues dhe rezervat	1,018		1,058	2,076
Fitimi (humbja) e vitit			67	67
Rezervat e rivlersimit		591		591
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera				
Total te hyra gjithëpërfshirëse				
Gjendja me 31 Dhjetor, 2024	1,018	591	1,125	2,734
Gjendja me 1 Janar, 2024	1,018	0	935	1,953
Korrigjimi për asete te gjetura				
Fitimi (humbja) e vitit			123	123
Te hyra gjithëpërfshirëse tjera				
Total te hyra gjithëpërfshirëse		0	1,058	2,076
Gjendja me 31 Dhjetor, 2024	1,018	0	1,058	2,076

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 8 deri 34 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
Pasqyra e rrjedhës së parasë 31 dhjetor 2024

	Shënimi	2024 (në '000 Euro)	2023 (në '000 Euro)
Rrjedha e para së nga aktivitetet operative			
Suficiti / Deficiti neto		67	123
Korrigjimet për zërat jo-ne para:	17-5	677	
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4&5	809	567
Te hyrat nga grantet	10	-220	-84
Vlera neto e aseteve te paprekshme	4&5		148
Te njohura shpenzime/hyrje	17-15	-33	0
Provizioni për borxhe të vjetra	7	30	59
Vlera neto e aseteve te shlyera			
Deficiti operativ para ndryshimeve në asetet			
Dhe detyrimet operative		1,330	813
(Rritja) / zvogëlimi I e stoqeve	6	10	9
Zvogëlimi/ (Rritja)në llogaritë e farkëtueshmet tregtare dhe të tjera	7	-61	301
(Zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	11	-273	-432
Rritje / (Zvoglëlim) i Detyrimet tjera afatshkurtra	18	42	374
Tatime te pagueshme	12	1	-111
Avanset nga klientet e marketingut		(94)	-154
Paraja e gjeneruar nga/(e përdorur në) aktivitetet operative		**955**	**800**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	**4**	-804	-319
Blerja e aseteve të paprekshme	**5**	-589	-297
Paraja e përdorur në aktivitetet investive		-1,393	**-616**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:			
Grandet e pranuara gjatë vitit	10	111	88
Kreditë e pranuar/(paguara) gjatë vitit			
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese		**111**	**88**
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve të parasë		**(327)**	**272**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		**332**	**60**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		**5**	**332**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të faqeve 8 deri 34 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Radio Televizioni i Kosovës është institucion publik me rendësi të posaçme kulturore dhe kombëtare, i cili ofron shërbim publik në fushën e veprimtarisë së radios dhe televizionit, e themeluar në përputhje me Rregulloren Nr. 2001/13 te UNMIK-ut, për themelimin e Radio Televizionit të Kosovës, e datës 15 Qershor 2001.
Themelues i RTK-ës si institucion publik është Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës mbron autonomin institucionale dhe pavarësinë editoriale si dhe te siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-ës. Me qëllim të sigurimit të funksionit të plotë në nivel profesional të RTK-ës themeluesi po ashtu garanton sigurimin e objekteve të përshtatshme punuese. Veprimtarinë e ka të përcaktuar me Ligjin për RTK-ën Nr.04/L-046 te datës 29 Mars 2012.

Entiteti është me bazë në Prishtinë, Kosovë dhe siguron shërbimin e transmetimit në gjithë rajonin e Kosovës duke u udhëhequr nga parimet e një Transmetuesi Publik, në përputhje me Kreu II. Neni 3 : Ligji për RTK-ën Nr. 04/L-046 te datës 29 Mars 2014.
Sipas Nenit 8. RTK përfshinë dy (2) kanale televizive (kanali televiziv ne gjuhen shqipe dhe kanali televiziv ne gjuhen serbe) dhe dy (2) kanale të radios të Kosovës. Këto dy (2) kanale janë të detyruara te ndajnë 15% të skemës se tyre programore për gjuhet e komuniteteve tjera të Kosovës.
Entiteti aktualisht vepron me katër kanale te televizionit dhe dy radio, të gjitha të vendosura në Prishtine.

Financimin e RTK-së e rregullon Ligji për RTK-ën Nr. 04/L-046; Kreu IV Neni 21.
Për një periudhë transitore deri trevjeçare , deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-ës do ti ndahen 0.7% e te hyrave nga Buxheti i Kosovës (duke përjashtuar të hyrat në Buxhetin e Kosovës nga Privatizimi, të hyrat e njëhershme dhe të hyrat vetanake nga niveli qendror dhe ai lokal), 10 % e buxhetit total te RTK-se i ndahet televizionit ne gjuhën serbe.
Organi drejtues i RTK-ës do të jetë Bordi i RTK-ës i përberë prej 11 anëtareve të cilët janë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës.(Kapitulli V Neni 24 paragrafi 1.1
Bordi i RTK-ës punon dhe vepron ne përputhje me dispozitat e ligjit dhe statutin e RTK-ës.

Numri i punonjësve në entitet me 31 Dhjetor 2024 ishte 867 duke përfshi të punësuarit e rregullt 703 punëtorë, menaxhmenti i lartë 4, bordi 6 anëtar, si dhe gjatë vitit ka pas te angazhuar me kontrata bashkëpunëtore profesional 147 të punësuar si: aktor, këngëtar etj, grupi këshillues dhe komitetit i Auditimit 7 të punësuar.

2. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara të Raportimit Financiar Ndërkombëtarë

Kompania ka miratuar të gjitha standardet edhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të obligueshme për periudhën e tanishme raportuese. Çdo Standard apo Interpretim i kontabilitetit ri ose i ndryshuar që nuk është ende i detyrueshëm nuk është miratuar më herët. Zbatimi i këtyre standardeve dhe interpretimeve nuk kishte ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- Ndryshimet në SNRF3 Referenca te Korniza Konceptuale
- Ndryshimet në SNK 16 Prona, Impiantet dhe pajisje - Të ardhurat para përdorimit të përcaktuar
- Ndryshimet në SNK 37 Kontrata e komplikuara – Kostoja e përmbushjes se një Kontrate

2.1 Përmirësimet Vjetore ndaj SNRF-ve; Standardet e Kontabilitetit Cikli 2018-2020

- SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
- SNRF 9 Instrumentet Financiare
- SNRF16 Qiratë
- SNK 41 Bujqësi

2.2 Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të miratuara

Standarde dhe interpretimet të reja janë publikuara që nuk janë obligative për periudhën raportueses me 31 dhjetore 2024 dhe të cilat nuk janë miratuara më herët nga Kompania.

Standardet dhe interpretimet qe janë nxjerrë, por nuk janë në fuqi, deri në datë e lëshimit të pasqyrave financiare të Kompanisë janë shpalosur më poshtë:

- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët.
- SNRF 17 "Kontrata e Sigurimit" duke përshirë ndryshimet në SNRF 17 (efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 Janarit 2024).
- Ndryshimi në SNK 1 Klasifikimi i pasiveve si afatshkurtër dhe afatgjatë
- Ndryshimet në SNK1 dhe SNRF Deklarata praktike 2: shpalosja e politikave të kontabilitetit
- Ndryshimi në SNK8 Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël
- Tatimi i shtyrë lidhur me Pasuritë dhe Detyrimet nga një Transaksion i Vetëm

Standardet e reja, rishikimet dhe interpretimet nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat të Institucionit në periudhën aplikimit fillestar.

2. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

3.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuar nga Bordi i Standardëve Ndërkombëtarë të Kontabilitetit("IASB").

3.2 Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike dhe të rivlerësimit i cili është bërë gjatë vitit 2024, të disa aseteve dhe detyrimeve financiare, siç është shpjeguar më poshtë në politikat e kontabilitetit.

3.3 Parimi i vazhdueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë. Operacionet e Kompanisë financohen nga buxheti i Kosovës duke siguruar kështu një vazhdimësi te operacioneve se paku edhe ne 12 Muajt e ardhshëm.

3.4 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euroja (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euroja ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

3.5 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj përveç Euros regjistrohen sipas kursit të këmbimit në fuqi në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit si rezultat i zgjidhjes së transaksioneve në valutë të huaj përveç Euros përfshihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit i cili është në fuqi në atë datë.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT(VAZHDIM)

Pasuritë dhe detyrimet monetare të shndërruara në valuta tjera përveç Euros kthehen në Euro sipas kursit mesatar të këmbimit në treg në datën e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet në valuta të huaja që ndodhin për shkak të këmbimit të aseteve dhe detyrimeve reflektohen në pasqyrën e të ardhurave si diference ndërmjet fitimeve dhe humbjeve për shkak të shndërrimit të kursit të këmbimit.

3.6 Prona, impiantet dhe pajisjet

Artikujt e pronës, impianteve dhe pajisjeve deklarohen sipas kostos së vlerësuar minus zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi.

Kostot pasuese janë të përfshira në vlerën bartëse të aseteve apo njihen si një aset i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur besohet që mund te këtë përfitime ekonomike në të ardhmen që lidhen me asetin të cilat do rrjedhin për Kompaninë dhe kostoja e asetit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet ngarkohen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato kanë ndodhur.

Zhvlerësimi në asetet llogaritet duke përdorur metodën e saldos zbritëse kufizuar për të shpërndarë koston e tyre në vlerën e tyre të mbetur gjatë kohëzgjatjes së vlerësuar të përdorimit siç vijon:

Pajisjet TV, Radio	10 vite
Pajisjet kompjuterike	5 vite
Mobile dhe orendi	10 vite
Mjete transportuese dhe inventar ekonomik	10 vite

Vlera e mbetur e aseteve dhe koha e përdorimit rishikohet, dhe korrigjohet nëse është nevoja, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera e bartur e asetit shlyhet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera e bartur e asetit është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga largimi nga përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

3.7 Asetet e paprekshme

Asetet e paprekshme përbëhen nga serialet dhe te drejtat televizive te blera. Këto fillimisht maten sipas kostos së tyre dhe më pas sipas kostos minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluara të dëmtimeve, nëse ka pasur. Amortizimi regjistrohet kur këto asete janë në dispozicion për përdorim duke përdorur metodën lineare sipas përqindjeve ne vijim:

	Transmetimi i I	Transmetimi i II	Transmetimi i III / vlere e mbetur
Kosto e zhvillimit të serialit	60%	30%	10%

Menaxhmenti i Kompanisë ka vendosur te ndryshoj politiken Kontabël për amortizimin e aseteve te paprekshme ne vitin 2020 duke kaluar nga metoda e saldos zbritëse ne metodën lineare. Pas parasysh qe ky ndryshim është bere me qellim te përshtatjes se shpenzimeve te amortizimit dhe prezantimit te një vlere me reale te pasurive te paprekshme, te gjitha ndryshimet janë aplikuar retrospektivisht dhe pasqyrat financiare janë ri deklaruar. Menaxhmenti po ashtu ka ndryshuar edhe vlerësimin mbi normat e amortizimit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.8 Dëmtimi i aseteve jo-financiare

Asetet që kanë kohë të pakufizuar të përdorimit nuk i nënshtrohen përdorimit dhe testohen në baza vjetore për dëmtim. Asetet të cilat i nënshtrohen amortizimit rishikohen për dëmtim kurdoherë kur ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera e bartur mund të mos jetë e rikuperueshme. Humbja nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera e bartur e asetit e tejkalon shumën e rikuperueshme të atij aseti. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës reale të asetit minus kostoja e shitjes dhe vlera në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, asetet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rrjedha të identifikueshme të veçanta të parave (njësi që gjenerojnë para). Asetet jo-financiare që kanë pësuar dëmtime rishikohen për rikthime të mundshme të dëmtimit në secilën datë raportuese.

3.9 Asetet dhe detyrimet financiare

Institucioni klasifikon investimet e saj në kategoritë e mëposhtme: asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, huave dhe llogarive të arkëtueshme, të mbajtura deri në maturim asetet financiare dhe asetet në dispozicion për shitje financiare. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilën investimet janë të fituara. Menaxhimi i përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë në çdo datë raportimi.

a) Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes
Kjo kategori ka dy nën-kategori: asetet financiare të mbajtura për tregtim dhe atyre të përcaktuar në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në fillim. Një aset financiar klasifikohet ne kategorinë e "aseteve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes" në fillim nëse është përfituar kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, nëse ajo është pjesë e një portofoli të aseteve financiare në të cilat ka prova afatshkurtër fitim-marrjen, ose në qoftë se kështu i caktuar nga Menaxhmenti.Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

b) Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme
Huat dhe llogaritë e arkëtueshme janë jo-derivativ aset e financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuara në një treg aktiv, përveç atyre që kompania synon të shesë në afat të shkurtër ose ajo i ka përcaktuar si me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes apo në dispozicion për shitje. Huat dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pastaj me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, duke zbritur provizionet për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim të huave dhe llogarive të arkëtueshme është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale.
Te Arkëtueshmet tregtare janë klasifikuar në këtë kategori.Ato njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas në shumat e rikuperueshme, minus provizioni për dëmtim. Një dispozitë për provizionimin e të arkëtueshmeve tregtare është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare të arkëtimit. Vështirësi të mëdha financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar dhe mosveprimi apo delikuenca në pagesa (më shumë se 30 ditë vonesë) janë konsideruar si tregues që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtar.
Shuma e mbartur e aktivit ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie provizioni, dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pakthyeshme, ajo shlyhet kundër llogarisë se provizionit te të arkëtueshmeve tregtare.Ri kthimet pasuese të shumave të shlyera më parë kreditohen në fitim ose humbje.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

C) Asetet financiare të mbajtura deri në maturim

Asetet financiare të mbajtura deri në maturim janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse të tjera përveç atyre që plotësojnë përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshme që Menaxhmenti i kompanisë ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim. Këto asete njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, duke zbritur provizionet për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim të letrave me vlerë të borxhit të mbajtura deri në maturim është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale.

(D) Asetet financiaretë vlefshme për shitje
Asete financiare në dispozicion për shitje janë asete financiare jo-derivative që janë të përcaktuara në këtë kategori apo nuk janë te klasifikuar në asnjë prej kategorive të tjera. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

Njohja fillestare dhe mosnjohja
Rregullt-mënyrë blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit - data në të cilën Kompania kryen për të blerë ose shitur aktivin. Aktivet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e të gjitha aktiveve financiare nuk kryhen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e tyre. Aktivet financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje të njihen fillimisht me vlerën e drejtë, dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitim ose humbje.
Aktivet financiare nuk njihen kur e drejta për të marrë flukset monetare prej tyre kanë skaduar ose kur ata janë transferuar dhe kompanisë ka transferuar edhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

Matjet e mëpasshme
Asetet financiare në dispozicion për shitje dhe asete financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes maten më pas me vlerën e drejtë. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe asetet financiare të mbajtura deri në maturim mbahen në koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet e realizuar dhe të parealizuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të kategorisë së "aseteve financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes" janë të përfshira në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato arrijnë. Fitimet e parealizuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave jo-monetare të klasifikuara si të disponueshme për shitje njihen në kapitalin neto.
Kur letrat me vlerë të klasifikuara si të disponueshme për shitje janë shitur ose dëmtuar, rregullimet e vlerës së drejtë të akumuluara janë të përfshira në fitim ose humbje si fitimet neto të realizuara / humbjet mbi asetet financiare.
Interesi në dispozicion për shitje i letrave me vlerë të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv është i njohur në fitim ose humbje. Dividendët nga instrumentat e mbajtura për shitje të kapitalit njihen në fitim ose humbje kur e drejta e kompanisë për të marrë pagesa është themeluar. Të dyja janë të përfshira në linjë të ardhurave nga investimet.
Vlerat e drejta te investimeve të cituara janë bazuar në çmimet e ofertës aktuale. Nëse tregu për një aset financiar nuk është aktiv, Kompania përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të vlerësimit. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve në gjatësinë e krahut, referenca për instrumente të tjera që në thelb janë të njëjtë, analiza e rrjedhës se parasë te diskontuaretj

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.10 Stoqet

Materialet, pjesët rezervë dhe materiali shpenzues vlerësohen sipas parimit të çmimit më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja përcaktohet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara në sigurimin e stoqeve dhe sjelljen e tyre në lokacionin dhe konditat ekzistuese. Vlera neto e realizueshme paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes në kursin e zakonshëm të biznesit, minus shpenzimet e aplikueshme variabile të shitjes.

3.11 Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme

Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme përfshijnë paratë e gatshme në dorë dhe në bankë. Për qëllime të rrjedhës së parasë, paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme paraqesin paratë e gatshme në dorë dhe depozitat e pakufizuara në banka me periudhë maturimi prej 3 muaj ose më pak.

3.12 Huamarrjet

Huamarrjet paraqesin kreditë që janë marr nga institucionet financiare dhe qeveritare dhe maten sipas vlerës së tyre reale në kohën e njohjes fillestare, duke qenë vlera e drejtë e shumës së marrë neto të kostos së transakionit të ndodhur. Pas njohjes fillestare huamarrjet njihen sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Kostot e huamarrjeve i atribuohen direkt blerjes, ndërtimit apo prodhimit të një aseti të kualifikuar, njihen si pjesë e kostos së atij aseti. Të gjitha kostot tjera të huamarrjeve njihen si shpenzim në përudhen në të cilën kanë ndodhur.

3.13 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe te tjera

Detyrimet për llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera maten sipas kostos e cila përfaqëson vlerën për shumën qe duhet te paguhet për mallrat apo shërbimet e pranuara pa marre parasysh a i janë faturuar apo jo kompanisë.

3.14 Kostot e përfitimeve të pensionimit

Kompania nuk bënë provizionin dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve përveç atyre te paguara pranë Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), referojuni edhe notës 25 gjithashtu.

3.15 Tatimi

Në përputhje me Ligjin 05/L-29 Tatimi mbi Korporata, Entiteti është i liruar nga tatimi në fitim, si institucion publik i themeluar nga Kuvendi i Kosovës.
Në përputhje me Ligjin 08/L-142.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.16 Njohja e të hyrave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e Entitetit kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t`u marrë
Të ardhurat njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike.

3.17 Grantet qeveritare

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ekzistojë siguri e arsyeshme që Institucioni do të respektojë kushtet e këtyre grandeve dhe që ato grande do të pranohen.

Grantet qeveritare kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë asete jo-rrjedhëse njihen si të hyra të shtyra në bilancin e gjendjes dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në bazë sistematike dhe racional përgjatë kohës së përdorimit të aseteve përkatëse.

Grantet tjera qeveritare njihen si e hyrë gjatë periudhave të nevojshme për t`i barazuar ato me shpenzimet të cilat ato kanë për qëllim t`i kompensojnë, në mënyrë sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet apo humbjet që tani kanë ndodhur apo që kanë për qëllim dhënien e përkrahjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa shpenzime që lidhen me të ardhmen njihen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

3.18 Provizionet

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim të tanishëm si rezultat i një ngjarjeje në të shkuarën dhe është e besueshme që një rrjedhë e burimeve që paraqesin përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të paguar një detyrim, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në lidhje me shumë e obligimit. Provizionet rishikohen gjatë secilës datë të bilancit të gjendjes dhe korrigjohen me qëllim që të reflektojnë vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të cilat priten të jenë të nevojshme për të paguar obligimin.

3.19 Zotimet dhe kontingjentet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Një detyrim kontingjent shpaloset në të gjitha rastet përveç rasteve kur mundësia e rrjedhës së burimeve që paraqesin përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundur. Shuma e një humbjeje kontingjente njihet si provizion nëse është e besueshme që ngjarjet në të ardhmen do të konfirmojnë që, një detyrim ka ndodhur deri më datën e bilancit të gjendjes dhe se mund të bëhen një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që pason.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

3.20 Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë

Nuk ka gjykime kritike, më përjashtim të atyre vlerësimeve të përfshira (shiko shënimin 3.21 më poshtë), që menaxhmenti i ka bërë në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Kompanisë dhe ajo ka pasur efekt të rëndësishme në shumat e njohura në këto pasqyra financiare.

3.21 Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

Jeta e dobishme e Pronave, impianteve dhe pajisjeve
Siç është shpjeguar në shënimin 3.8 më sipër. Kompania rishikon jetën e dobishme te pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të secilës periudhë të raportimit. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktorëve tjerë mund të ndikojë në jetën e dobishme të aseteve dhe rrjedhimisht mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme ne shumën e bartur të këtyre aseteve.

Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe stoqet:
Në rrjedhën normale të biznesit, Entiteti bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Duke u bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave dhe shlyerjen e stoqeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimi i rasteve ligjore:
Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën një vlerësim për shumat që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Kompanisë. Në bazë të këtij vlerësimi, kompania në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

4. PRONA IMPIANTET DHE PAJIMET

Objektet e ish-RTP-së shfrytëzohen nga RTK, sipas vendimit të UNMIK[1]. Sikurse edhe të gjitha pronat e tjera shoqërore, edhe pronat e ish RTP-së ishin deri në momentin e shpalljes së pavarësisë nën mandatin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (Agjenci nën autoritetin e UNMIK). AKP asnjëherë nuk e kishte kontestuar vendosjen e RTK-së në pronën e ish RTP-së.
Kontestimin e shfrytëzimit të objekteve nga RTK e kishte bërë Agjencia Kosovare e Privatizimit, për shkak të neglizhencës së Kuvendit të Kosovës që të zgjidhë çështjen e pronës së RTK-së, si transmetues publik i Republikës së Kosovës, e që është dhe obligim ligjor i saj.

	Objekti	Pajisjet për transmetim	Automjetet	Pajisje dhe kompjuterët	Inventari	Investimet ne vijim	Totali
Kosto							
Me 01 Janar 2024	514	2,783	208	1,757	525		5,787
Blerjet gjatë vitit	17	367		232	188		804
Rivlerësimi i Aseteve	84	112	24	266	57		543
Me 31 Dhjetor 2023	**615**	**3,262**	**232**	**2,255**	**770**	**0**	**7,134**
Zhvlerësimi i Akumuluar							
Me 1 Janar 2024	(357)	(1,367)	(162)	(1,503)	(271)	0	(3,657)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(29)	(198)	(0)	(112)	(44)		(383)
Shpenzimet nga rivlerësimi	(26)	(214)	(21)	(59)	(51)		(371)
Me 31 Dhjetor 2024	**(412)**	**(1,779)**	**(183)**	**(1,674)**	**(366)**	**0**	**(4,411)**
Vlera neto							
Me 1 Janar 2024	**160**	**1,416**	**46**	**254**	**254**	**0**	**2,130**
Me 31 Dhjetor 2024	**206**	**1,483**	**49**	**581**	**404**	**0**	**2,723**

Sipas Raportit të rivlerësimit me numër 2486/24dt 04.12.2024 Ndërtesat të cilat i përdore RTK-TV ka një vlere financiare 3,200 milion, dhe e Radios 6,974 milion euro.

4. PRONA IMPIANTET DHE PAJIMET (Vazhdim)

	Objekti	Pajisjet për transmetim	Automjetet	Pajisje dhe kompjuterët	Inventari	Investimet ne vijim	Totali
Kosto							
Me 01 Janar 2023	514	2,642	208	1,731	469	148	5,711
Blerjet gjatë vitit		151		70	98		319
Shlyerjet gjate vitit		(10)		(44)	(42)	(148)	(244)
Me 31 Dhjetor 2023	**514**	**2,783**	**208**	**1,757**	**525**	**0**	**5,787**
Zhvlerësimi i Akumuluar							
Me 1 Janar 2023	(274)	(1,139)	(129)	(1,440)	(247)	0	(3,229)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(80)	(234)	(33)	(101)	(50)		(497)
Shlyerjet		6		37	26		69
Me 31 Dhjetor 2023	**(354)**	**(1,367)**	**(162)**	**(1,504)**	**(271)**	**0**	**(3,657)**
Vlera neto							
Me 1 Janar 2023	**240**	**1,503**	**79**	**291**	**222**	**148**	**2,483**
Me 31 Dhjetor 2023	**160**	**1,416**	**46**	**253**	**254**	**0**	**2,130**

5. ASETET E PAPREKSHME

Përshkrimi	Saldo fillestare	Blerja	Zhvlerësimi	Rivlerësimi	Shp.Rivlerësimi	Shlyrja/Emetimi	Vlera neto
Të drejtat e programit	202	507				(677)	32
Materiali ne arkiv, Seriali "Tosta te Suki"	78		(70)				8
Filma Donacion nga Ambasada Norvegjeze	17			2	(3)		16
Filma Donacion nga Ambasada Italiane	0	80		4	(52)		32
Softvera per nevojat e IT-së	1	2		35			38
Materiali ne arkiv "Kodi i Jetës"	0			5			5
Materiali ne arkiv filma "Kosova Film"	0			3			3
Materiali ne arkiv, Seriali "Kafeneja Jone"	409						409
Materiali ne arkiv "Oksigjeni"	179						179
Materiali ne arkiv "Familja Moderne"	182						182
Arkivimi i shiritave filmik	29						29
Materiali ne arkiv "Vikendi"	52						52
Materiali ne arkiv "Frekuenca e Quzes"	20						20
Materiali në arkiv "Stinë Dashurie"	30						30
Materiali ne arkiv "Lagjja e re"	23						23
Materiali në arkiv "Çka ka shpija"	139						139
Materiali ne arkiv "Qyteti pa lum"	22						22
Materiali në arkiv "Zyra për gjithçka"	21						21
Materiali në arkiv "Nje Univers"	17						17

Materiali ne arkiv "Zogjtë e luftës"	16						16
Materiali me arkiv "Shtepia Ime"	14						14
Materiali ne arkiv "Labyrinth X"	25						25
Materiali ne arkiv "Show Meselation"	3						3
Materiali ne arkiv "Krejt Ashiqare"	8						8
Materiali ne arkiv "192"	27						27
Materiali ne arkiv "Gjurmet"	3						3
Materiali ne arkiv "Pleqtë"	2						2
Materiali ne Arkiv "Kukumi"	2						2
Materiali ne Arkiv "Tensioni i lartë"	3						3
Materiali ne Arkiv "Vjeshtë e Zymtë"	2						2
Materiali ne Arkiv "Ngjyra jete"	1						1
Materiali ne Arkiv "Dashuria"	1						1
Materiali ne Arkiv "Kur te kthehet Ramizi"	1						1
Materiali ne Arkiv "Nje çerek shekulli"	1						1
Materiali ne Arkiv "E di se kam pasur nje titull"	1						1
Materiali ne arkiv "Egjeli"	9						9
Materiali ne arkiv "Tre gjermanet e trashë"	12						12
	1,552	**589**	**(70)**	**49**	**(55)**	**(677)**	**1,388**

6. INVESTIMET NE SHOQËRI

Gjate vitit 2006. Organizata ka nënshkruar një kontrate për aksionet e transferuara me Rrjetin Kosovar për Telekomunikacion Tokësor KTTN LLC ne vlere 1 mije EURO, organizata nënshkroi për 875 aksione me vlere nominale 1 EURO për aksion nga kapitali aksionar i Rrjetit Kosovar për Telekomunikacion Tokësor KTTN LLC.

7. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 Dhjetor, 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (në '000 Euro)
Llogaritë e arkëtueshme tregtare:		
Kërkesat nga marketingu	250	202
Kërkesat ndaj transmetuesve		
	250	**202**
Provizioni për dëmtime	(17)	(17)
	233	**185**
Llogaritë e arkëtueshme të tjera:		
Paradhëniet furnitorëve	3	1
Tjera	115	104
Provizioni për dëmtime	(59)	(59)
	59	**46**
	192	**231**

Lëvizja në provizionin e borxheve të këqija:

	Më 31 Dhjetor, 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (në '000 Euro)
Gjendja më 1 Janar,	76	109
Ngarkesa për periudhën	0	0
Inkasimet gjatë vitit	0	(4)
Shlyerjet gjatë vitit	0	(29)
Gjendja më 31 Dhjetor	**76**	**76**

	Më 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (në '000 Euro)
Shpenzimet nga provizionimi	**30**	**42**

8. PARAJA DHE EKUIVALENTET E PARASE

	Më 31 Dhjetor, 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (në '000 Euro)
Paraja në banka – në llogaritë rrjedhëse	5	332
Paraja në dorë	0	
	5	**332**

9. KAPITALI THEMELUES

Kapitali Shoqëror i Entitetit në Bilancin e Gjendjes është i përberë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor, 2024 (ne 000 euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (ne 000 euro)
Kapitali dhe rezervat	1,018	1,018
Totali i kapitalit	**1,018**	**1,018**

	Më 31 Dhjetor, 2024 (ne 000 euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (ne 000 euro)
Fitimi i mbajtur	1,125	1,058
Totali	**1,125**	**1,058**

9a. REZERVAT E RIVLERSIMIT

Radio Televizioni i Kosovës gjatë vitit 2024 sipas rekomandimit nga ZKA ka bërë rivlerësimin e të gjitha pasurive të cilat i ka në përdorim.
Raporti me numër 2486/24 dt 04.12.2024.

	Më 31 Dhjetor, 2024 (ne 000 euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (ne 000 euro)
Rezervat e rivlerësimit	591	0
Totali	**591**	**0**

10. GRANTET E SHTYERA

RTK ka grantet të shtyra të pranuara për financimin e pasurive afatgjata. Bilanci i mbetur me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

	Fund viti 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Fund viti 31 Dhjetor 2023 (në '000 Euro)
Më 1 Janar,	736	733
Te pranuara gjatë vitit	111	88
Të amortizuar gjatë vitit (Shënimi 15)	(220)	(84)
Gjendja më 31 Dhjetor,	**627**	**736**

11. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE DHE TË TJERA

	Më 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (në '000 Euro)
Furnitorët		
Furnitorët vendor	449	854
Furnitorët e huaj	135	3
Totali i LLP	**584**	**857**
11a. Tjera parapagime	55	149
	0	**0**
Totali nga parapagimi	**55**	**149**

12. TATIME TË PAGUESHME

	Më 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (në '000 Euro)
Obligimet për tatim	1	0
Obligimet për kontribute pensional	0	0
	1	**0**

13. TE HYRAT NGA BUXHETI

Bazuar ne ligjin për Buxhet e Kosovës vitit 2024, Qeveria e Kosovës ka ndarë buxhetin për të financuar aktivitetin e RTK-së në vlerë prej 8.960 mije EURO për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor:

	Fund viti 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Fund viti 31 Dhjetor 2023 (në '000 Euro)
Të hyrat nga buxheti	8.960	8.960
Gjendja më 31 Dhjetor,	**8,960**	**8,960**

14. TË HYRAT NGA MARKETINGU

	Fund viti 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Fund viti 31 Dhjetor 2023 (në '000 Euro)
Te hyrat nga marketingu	657	479
Te hyrat nga sponzorizimet	57	45
	714	**524**

15. TË HYRAT TJERA

	Fund viti 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Fund viti 31 Dhjetor 2023 (në '000 Euro)
Të hyrat nga vendosja e antenës	60	61
Të hyrat nga grantet	220	84
Të hyrat nga monetizimi	104	122
Të hyrat nga korrigjimi i LLP	219	495
Të hyrat nga Festivali i Këngës	300	300
Te hyrat tjera	284	124
	1,187	**1,186**

16. SHPENZIMET E PERSONELIT

	Fund viti 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Fund viti 31 Dhjetor 2023 (në '000 Euro)
Pagat e punëtorëve të rregullt	6.504	6.757
Pagat e kontraktuara- Menaxhmenti	88	117
Pagat e Bordit	102	115
Mëditjet e grupit këshillues të publikut	3	4
Komiteti i Auditimit	3	4
Kontributet personale	363	383
Shtesat- Kontrata Kolektive	86	99
Korrespodentët	19	19
Shërbimi Programore (Festivali,Koncerti)	132	192
Përkthimet	23	15
Viti i ri	20	40
Mëditjet	3	4
Big Bandi i RTK-së	5	0
Shujta ditore	377	402
	7,728	**8,151**

17. SHPENZIMET E PROGRAMITE DHE TE TJERA

	Fund viti 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Fund viti 31 Dhjetor 2023 (në '000 Euro)
Shpenzimet e furnizimit të materialit	22	29
Energjia elektrike	105	105
Uji	8	10
Mbeturinat	3	8
Termokos	12	14
Shërbimet kontraktuese- Korrespodentët	24	33
Telefonia fikse dhe mobile	42	55
Interneti	59	58
Web faqja	13	12
Shpenzimet për udhëtime zyrtar tjera	64	71
Derivatet e naftës	39	41
Derivatet e naftës për ngrohje	23	8
Mirëmbajtja e automjeteve	3	9
Mirëmbajtja e pajisjeve	55	33

Mirëmbajtja higjienike e objekteve te RTK-së	10	24
Shfrytëzimi i automjeteve me qira	76	92
Mirëmbajtja e adresave elektronike	31	31
Sigurimi i objektit	60	59
Renovimi	3	14
Licenca për frekuenca	29	26
Kontrata me EBU dhe Fidat	60	58
KTTN-ja	69	76
Programi	161	126
Shërbime programore	3	22
Te drejtat e sportit pasuri e paprekshme	677	0
Te drejtat e sportit	282	48
Skenografia	3	8
Programi i vitit të ri	13	19
Produksionet e pavarura (20%)	78	0
Çregjistrimi i MTH	0	27
Shtyrja e investimeve afatgjata	0	148
Shpenzime të tjera	94	60
Korrigjimi i LLA	0	42
Shpenzimet e Përmbaruesve	53	20
Shpenzimet nga vitet paraprake	11	27
	2,185	**1,413**

18. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Me 31 dhjetor 2023, Entiteti ka pasur zotime sipas:

Zotimet:

1. Procesi gjyqësor ka filluar në vitin 2014 kur edhe është iniciuar padia për kompensim dëmi nga ana e paditësit Grand Media SH.P.K. Fillimisht, Gjykata e Apelit ka nxjerr Aktgjykimin me të cilin ka aprovuar kërkesën e palës paditëse në vlerë prej 1,963,751.54 €. Me ankesën e palës së paditur RTK, rasti është kthyer në rigjykim, ku është marrë Aktgjykimi me të cilin Gjykata ka aprovuar vlerën prej 373,741.54 €.

Duke qenë se në Kontratën nr. 1283/11, respektivisht neni 14, parashihet që në rast të ndërprerjes të bashkëpunimit njëanshëm atëherë si dëmshpërblim RTK duhet të paguaj shpenzimet pesë mujore palës paditëse, shumë të cilën Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë ka aprovuar me Aktgjykimin KE.nr.829/22, në emër të dëmit të shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës nr. 1283/11, shumën prej 340.808,00€ dhe në emër të borxhit shumën prej 32.933.54€, gjithsej shumën prej 373,741.54 € me kamatë ligjore si për mjete të deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti, të llogaritura nga data e parashtrimit të padisë 28.05.2014.

RTK brenda afatit ligjor ka deponuar ankesën ndaj Aktgjykimit KE.nr.829/22 në Gjykatën Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë.

Rrjedhimisht, në bazë të dokumentacionit përkatës, ecurisë së lëndës në gjykatë, zyra ligjore lidhur me detyrimin kontingjent ka dhënë parashikimin e arsyeshëm të shumës si rezultat i humbjes që mund të bëhet gjatë vitit 2024.

Me 31 dhjetor 2024, Entiteti ka pasur zotime sipas:

2. Me datën 19.06.2020 kemi pranuar Urdhrin Përmbarimor nga ana e Kreditorit APIK përmes Përmbaruesit Privat Atip Mustafa e që mban numrin P.nr.1470/20

Aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr.455/23 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë me të cilin Refuzohet ankesa dhe mbetet në fuqi Aktvendimi KPPP.nr.285/22.

Shuma totale për pagesë sipas Vërejtjes së fundit është në vlerë prej 41.955.24 Euro

	Më 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor, 2023 (në '000 Euro)
Shpenzimet kontingjente	42	374
	42	**374**

d) Detyrimet kontingjente

Që nga data e këtyre pasqyrave financiare, RTK-ja, ka pranuar gjithsej gjashtëdhjetë e shtatë (67) Aktvendime/Aktgjykime:

Nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar tetëmbëdhjetë (18) aktvendime/aktgjykime, nga Gjykata e Apelit katër (4), nga Gjykata Supreme katër (4), ndërsa nga Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë gjithsej njëzet e një (21) dhe nga Shkalla e Dytë e Gjykatës Komerciale kemi pranuar njëzet (20) aktvendime/aktgjykime.

Në favor të RTK-së janë gjashtëmbëdhjetë (16) aktvendime/aktgjykime; Katër (4) nga Gjykata Themelore në Prishtinë, një (1) nga Gjykata e Apelit, një (1) nga Gjykata Supreme, katër (4) nga Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë dhe gjashtë (6) nga Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë.

Gjendja e detyrimeve kontingjente mund të ndryshoj, varësisht prej Vendimeve të Gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve .

19. KATEGORITE E ASETEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Vlera kontabël e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare për secilën kategori janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Pasuritë financiare		
Huat dhe arkëtimet (kostoja e amortizuar)		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	292	231
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	332
	297	**563**
Detyrimet financiare		
Detyrime të tjera (kosto e amortizuar)		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	584	857
	584	**857**

20. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a. Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Themelues i institucionit publik të RTK-së është Kuvendi i Kosovës. Është detyrë e themeluesit që të mbrojë autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale të RTK-së dhe të sigurojë financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së

Struktura e kapitalit të Entitetit përbëhet prej huave dhe ekuitetit që i atribuohet zotëruesve të ekitetit, përfshirë kapitalin, rezervat dhe humbjet e mbajtura.

Raporti ndërmjet kapitalit të pronarit dhe borxhit të jashtëm
Menaxhmenti vazhdimisht e rishikon strukturën e kapitalin. Si pjesë e këtij rishikimi, menaxhmenti e konsideron koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur më secilën klasë të kapitalit.Raporti ndërmjet kapitalit të pronarit dhe borxhit të jashtme në fund të vitit ishte si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024 (në '000 Euro)	Më 31 Dhjetor 2023 (në '000 Euro)
Borxhi	1,056	1.380
Ekuiteti	2,734	2,076
Raporti borxh/ekuitet	39%	66%

20. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b. Rreziku kreditor

Kompania i nënshtrohet rrezikut kreditor nëpërmjet aktiviteteve të saja të shitjes. Në këtë respekt, rreziku kreditor për Kompaninë buron nga mundësia që palët e ndryshme mund të mos paguajnë obligimet e tyre sipas kontratës. Shuma e ekspozimit kreditor me këtë rast përfaqësohet nga shumat e bartura të aseteve në datën e bilancit të gjendjes. Prandaj, llogaritë e arkëtueshme tregtare monitorohen në baza mujore dhe konsumatorëve u tërhiqet vërejtja me kohë.
Shuma e bartur e aseteve financiare të regjistruara në pasqyrat financiare, e cila është neto nga humbjet nga dëmtimet, përfaqëson ekspozimin maksimal të Kompanisë ndaj rrezikut. Rreziku i kredisë për para dhe ekuivalentë të saj konsiderohet i papërfillshëm, pasi palët janë banka me reputacion. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në Pasqyrën e pozicionit financiar, siç thuhet në tabelën e mëposhtme:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Pasuritë financiare		
Huatë dhe arkëtimet		
Të arkëtueshme tregtare	292	231
Të arkëtueshme të tjera		
	292	231
Paraja dhe ekuivalentët e saj	5	332
	297	**563**

c. Rreziku i tregut

Aktivitetet e Kompanisë ekspozojnë atë fillimisht në rrezikun financiar të ndryshimeve në normat e interesit, siç është paraqitur më poshtë në 17 (d). Rreziku i tregut nuk koncentrohet në rrezikun valutor, pasi që shumica e transaksioneve të Kompanisë janë në valutën lokale.

d. Rreziku nga norma e interesit

Rreziku nga norma e interesit përbëhet nga rreziku që vlera e pasqyrave financiare do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe nga rreziku i ndryshimit ndërmjet maturimit të aseteve që janë me interes dhe maturimit të detyrimeve që janë me interes dhe janë marr për të financuar ato asete (re-pricing risk). Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit në një instrument financiar është fikse tregon se deri në çfarë mase ajo është e ekspozuar ndaj rrezikut nga norma e interesit.

Menxhmenti beson se Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit në pasqyrat e saj financiare përveç për huamarrjet, të cilat bartin normë fikse të interesit.

Menaxhmenti beson se përveç huamarrjeve Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normave të interesit në pasqyrat e saj financiare. Më 31 dhjetor 2024 kompania nuk ka huamarrje ndaj palëve te treta.

20. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Më 31 Dhjetor 2024	Deri në 3 muaj	Prej 3 deri 12 muaj	Prej 1 deri 5 vjet	mbi 5 vjet	Që nuk sjellin interes	Totali
	----------Qe sjellin Interes----------					
	----------(in EUR '000)----------					
Asetet financiare						
Paraja në dorë dhe në bankë					5	5
Llogaritë e arkëtueshmet tregtare					292	292
Gjithsejtë asetet financiare					**297**	**297**
Detyrimet financiare						
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera					584	584
Tatimet e pagueshme					1	1
Avanset e pranuara për marketing					55	55
Kontingjentet					416	416
Gjithsejtë Detyrimet financiare					**1,056**	**1,056**
Hendeku i rrezikut të interesit, neto					**(759)**	**(759)**
Hendeku kumulativ më 31 Dhjetor 2024					**(759)**	**(759)**

MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Më 31 Dhjetor 2023	Deri në 3 muaj	Prej 3 deri 12 muaj	Prej 1 deri 5 vjet	mbi 5 vjet	Që nuk sjellin interes	Totali
	----------Që sjellin Interes----------					
	----------(in EUR '000)----------					
Asetet financiare						
Paraja në dorë dhe në bankë					332	332
Llogaritë e arkëtueshmet tregtare					231	231
Gjithsejtë asetet financiare					**563**	**563**
Detyrimet financiare						
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera					857	857
Tatimet e pagueshme					0	0
Avanset e pranuara për marketing					149	149
Kontingjentet					374	374
Gjithsejtë Detyrimet financiare					**1,380**	**1,380**
Hendeku i rrezikut të interesit, neto					**(817)**	**(817)**
Hendeku kumulativ më 31 Dhjetor 2023					**(817)**	**(817)**

